

VENDIM
Nr. 57, datë 3.2.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 445, DATË 22.5.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË LIMITIT ORGANIK
DHE PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË
NË GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 8869 datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 445, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe